

## Shtojca 15

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

*Pogradec, më 08.04.2021*

Për: Operatorin Ekonomik "BENAKS - 94" SHPK, me numër NIPT: J73804663H, me adresë sipas ekstraktit të QKB-së "Rruga nacionale Pogradec Korçe, Km 1, krahu i djathtë, pranë kryqezimit Buçimas", perfaqësuar nga Administratori i shoqërisë z. Besnik IBI.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozime" - "Punë" - "Prokurim elektronik" - "Me lote".

Numri i referencës së lotit I: REF-89431-03-09-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti I "**Mirembajtje kanali ujites Qafe Plloce - Bahcallek**", me fond limit **898 944** (Teteqind e nenteqind e tete mije e nenteqind e dyzete e kater) lekë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 38 datë 16 Mars 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

#### **1. AL - Dok SHPK**

**NIPT: J64103601Q**

Vlera pa TVSH: 756 700 (Shtateqind e pesedhjetë e gjashtë mije e shtateqind) lekë.

#### **2. BENAKS - 94 SHPK**

**NIPT: J73804663H**

Vlera pa TVSH: 791 565 (Shtateqind e nentedhjetë e një mije e pesëqind e gjashtedhjetë e pesë) Lekë

#### **3. JOKLEN&CO SHPK**

**NIPT: K84322601F**

Vlera pa TVSH: 791 930 (Shateqind e nentedhjetë e një mije e nenteqind e tridhjetë) lekë.

Eshtë skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

**1. AL - Dok SHPK**

**NIPT: J64103601Q**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**A.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **Al - Dok SHPK, NIPT: J64103601Q**, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur ne S.P.E, NUK është ne përputhje me kriteret e vendosura ne DST, duke i parashtruar si me poshtë vijon:

**1.** Nuk deshmon qe ka te punesuar me kontrate pune dhe diplomën perkatëse, nje inxhinier ndertimi, pasi administratori i shoqerise kryen veprimtari administrative te shoqerise, dhe nuk merr pjese ne proceset e zbatimit te punimeve, duke qene se u shpall fitues ne Loti II.

**2.** Duke qene se u shpall fitues ne LOTI II, ne zbatim te Rekomandimit te APP-së Nr. 6732 prot, datë 21.10.2020, perderisa operatori ekonomik ka ofruar ne me shume se nje lot, atehere nuk provon, se disponojne aftesite teknike dhe gjendjen ekonomike financiare per realizimin e te gjithave objekteve, Loti I, dhe Loti III.

Posacerisht nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme, per nje objekt te vetem.

Per sa me siper, Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit,

**VENDOSI:**

Të S'kualifikojë ofertën e e paraqitur nga Operatori Ekonomik **Al - Dok SHPK, NIPT: J64103601Q**, me vlere 756700 leke pa TVSH.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "BENAKS - 94" SHPK, me numër NIPT: J73804663H, me adresë sipas ekstraktit të QKB-së "Rruga nacionale Pogradec Korçe, Km 1, krahu i djathtë, prane kryqezimit Buçimas", perfaqësuar nga Administratori i shoqërisë z. Besnik IBI, se oferta e paraqitur, me një vlerë pa TVSH prej 791 565 (Shtatëqind e nentëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ndermarrjes se Mirembajtjes se Infrastrukturave dhe Puneve Publike, Bashkia Pogradec*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (Pese) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi në buletin e APP-se.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të ndiqen procedurat siç parashikohet në Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 31.03.2021

Ankesa: JO

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]**

**ENTON BERBERI**